

Fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit në Hamburg mund të përfitojnë nga paketa arsimore dhe paketa pjesëmarrës (BuT).

Ju tashmë keni marrë ose keni të drejtë për...

- përfitime sipas Kodit Social Gjerman II (pagesë papunësie II apo ndihmë ekonomike)
- përfitime sipas Kodit Social Gjerman XII (Ndihmë sociale ose Ndihmë bazike)
- përfitime në kuadrin e ligjit për fitimin e të drejtës për azil
- pagesë për banesë
- pagesë për fëmijë sipas Ligjit federal për fëmijë

Më pas Ju ose fëmijët Tuaj mund të aplikojnë edhe për përfitime shtesë:

- **Ekskursionet dhe udhëtime me kopshtin, tavolina dreke pedagogjike, udhëtime me kujdesin për fëmijët dhe në shkollë**
Do të mbulohen vetëm kostot faktike. Paratë e xhepit nuk do të merren përsipër.
- **Nevoja shkollore për nxënës**
Për materialet mësimore fëmijëve në shkollë do t'u paguhet një grant prej gjithsej 100 Euro në vit, në fillim të vitit shkollor 70 Euro dhe në shkurt 30 Euro.
- **Shpenzime transporti në shkollë**
Shpenzimet e nevojshme për udhëtim në shkollë do të merren përsipër . Në Hamburg vlejnë direktivat për para udhëtimit për nxënësit.
- **Kujdestari gjatë drekës në çerdhe, dreka pedagogjike, kujdes gjatë ditës në kopshte dhe në shkollë**
Shpenzimet për drekën në shkollë do të merren përsipër nga përfituesit e BuT (Formim dhe Transport). Dreka në çerdhe në Hamburg është për të gjithë fëmijët pa pagesë.
- **Subvencionim arsimor**
Nxënësit do të marrin subvencionim shtesë pa pagesë (suport), nëse rrezikohet arritja e objektivave thelbësor arsimor sipas vlerësimit të shkollës.
- **Kultur, Muzikë, Sport dhe pajisje përkatëse**
Merren përsi për kontributet për anëtarësim, për tarifa pjesëmarrjeje apo të ngjashme në vlerën prej maksimalisht 10 Euro në muaj për oferta të përbashkëta kulturore, muzikore apo sportive, për kohën e lirë apo për marrjen me qira të pajisjeve për aktivitete të tilla.

Udhëzime të veçanta për përfituesit e parave për strehim dhe për fëmijë:

Para se të paraqiteni për të marrë përfitimet ju lutemi të paraqisni gjithmonë vendimin e aktualizuar për paratë për strehim dhe për pagesë për fëmijët tek Qendra Juaj Profesionale për sigurimin bazë dhe social apo tek Qendra e Shërbimeve Sociale.

Ku të aplikoni për këto përfitime?

Përfitime për **Kulturën, Muzikën dhe Sportin** ju mund të merrni duke aplikuar në formularin e Vendimit të Autorizuar apo me një Njoftim të shkurtër direkt tek ofruesi i përfitimeve. Përderisa Ju do të përdorni shumën për të blerë apo për marrje me qera të **pajisjeve**, Ju duhet të plotësoni një formular më vete bashkë me ofruesin e përfitimeve dhe ta dërgoni më pas këtë me postë në Zyrën e Qarkut Eimsbüttel, Qendra e Bilancit për Arsimim dhe Pjesëmarrje, Grindelberg 62-66, 20144 Hamburg..

Përfitimet për **nevoja shkollore** normalisht do të kompensohen automatikisht. Nëse fëmija Juaj është nën 7 vjeç ose mbi 15 vjeç apo nëse Ju merrni para për strehim apo për fëmijët, Ju duhet të aplikoni paraprakisht për këtë përfitim në Qendrën Sociale përkatëse:

- Qendra e Punës (për kërkues në kushte normale sipas KODIT SOCIAL GJERMAN II)
- Zyra Profesionale për sigurinë bazë dhe sociale apo në Qendrën e Ndhmës Sociale në Zyrën e Qarkut (për kërkues në kushte normale sipas KODIT SOCIAL GJERMAN XII apo edhe sipas Ligjit për azilkërkues dhe për përfituesit e parave për strehim dhe për fëmijët).

Këto përfitime do ti aplikoni direkt në shkollë:

- Dreka në shkollë
- Subvencionim arsimor
- Shpenzime transporti për në shkollë

Shpenzimet për **ekskursione njëditore apo udhëtime disaditore** me kopshtin, mësuesit, në kuadrin e kujdesit ditore apo me shkollën, duhet të vërtetohen nga institucioni me një formular për konfirmim shpenzimesh. Këtë do e dorëzoni tek Qendra Sociale respektive. **E veçantë:** Përfituesit sipas SGB II i dërgojnë aplikimet e tyre për ekskursione një ditore gjithmonë direkt tek Zyra e Qarkut Eimsbüttel, Qendra e Bilancit për Arsimim dhe Pjesëmarrje, Grindelberg 62-66, 20144 Hamburg.

Për **drekën pa pagesë** në kopshte, shkolla apo në kujdesin ditor gjatë aplikimit ju lutemi të paraqisni kur aplikoni për kupon kopshti në Zyrën e Qarkut vendimin autorizues ose një vendim të shkurtër.

Informacione të tjera do të merrni

- në shkolla,
- nën faqen www.hamburg.de/bildungspaket
- ose nga shërbimi telefonik në Hamburg, Telefon 040 - 428 280